



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:235931  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05463543

C-IV-14-6649

*Paditësi*; E B të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokati D B nga Ferizaj.

Kundër

*Pala e paditur*: NSH Eurometal me seli në Ferizajn e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi me datën; 18.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadija e parashtruar nga E B, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi i Autoritetit Likuidimit që evidentohet me numër GJI057-0206, i datës 16.07.2013.
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.
- III.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 21.10.2014, pranë DHPGJS është parashtruar padi nga paditësi E B, kundër të paditurës NSH Eurometal me seli në Ferizaj e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në lidhje me vendimin me nr. GJI057-0206, të datës 16.07.2013 të lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit të NSH Eurometal (në likuidim), me të cilat i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim të pagave në shumën prej 2,200.00 €, për periudhën nga muaji maj e deri në muajin tetor 1990, si ish punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore Eurometal (në Likuidim).

Parashtruesi i padisë ndër të tjera ka theksuar se pranë Autoriteti të Likuidimit ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën nga muaji maj e deri në muajin tetor 1990, në shumën prej 2,094.00 €. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin e kontestuar kërkesën për kompensim të pagave të lartë cekura e ka refuzuar si të pa bazuar. Me tuje ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie të përhershme pune në fabrikën e këmbyesve të nxehtësisë Faknit në Ferizaj e cila para privatizimit është quajtur NSH Eurometal.

Po ashtu ka theksuar se nga ndërmarrja në fjalë nuk i janë kompensuar të ardhurat për periudhën maj-tetor 1990, ndërsa në muajin nëntor është larguar nga puna me një vendim arbitrar dhe të kundërligjshëm të Këshillit të Përkohshëm të Ndërmarrjes.

Me tutje në padinë e ushtruar ka theksuar se në lidhje me largimin e kundërligjshëm nga puna ka ushtruar padi në Gjykatën Kompetente kundër vendimit mbi largimin arbitrar nga puna po ashtu në padi ka qenë e përfshire edhe kërkesa për kompensimin e pagave. Mirëpo kjo lëndë nuk është vendosur nga gjykata. Meqenëse kjo padi nuk është zgjidhur nga gjykata nuk është kontestuese se për periudhën në fjalë ka qenë në marrëdhënie punë në ndërmarrje. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të prova të lëndës të marr aktgjykim me të cilin kërkesëpadija e tij të aprovohet si e bazuar dhe të detyrohet NSH Eurometal (në likuidim) që në emër të kompensimit të pagave nga muaji maj deri në muajin tetor 1990, t'ia kompensoj shumën prej 2,094.00 €, me kamatë ligjore nga muaji prill 2006, e deri në pagesën definitive.

Kësaj padie si provë ia ka bashkangjitur:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr GJI057-0206, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruara nga pala ankuese para Autoritetit të Likuidimit;*
- *Regjistrimin e punëtorëve për realizimin e të ardhurave pranë NSH Faknit për muajit maj-tetor 1990;*
- *Propozimin e ushtruar pranë Gjykatës së Punës së Bashkuar;*

Pala e paditur me datën 20.06.2022, ka parashtruar mbrojtjen ndaj padisë së ushtruar nga E B,ku ndër të tjera ka theksuar se Ndërmarrja Shoqërore Eurometal (në likuidim) ka hyrë në procedurë të likuidimit me datën 17.03.2006. Me datën 27.03.2008, pala paditëse në atë procedurë ka parashtruar një kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 2.200.00 € Autoriteti i Likuidimit mori vendim me të cilin kërkesën për kompensim të pagave e ka refuzuar në tërësi. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit me nr.04/L-034 për AKP-në.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar pala e paditur ka theksuar se i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të saktë. Objekt i kësaj procedure është ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Padija e ushtruar nga parashtruesi i saj nuk i përmban kriteret e pranueshmerisë siç parashihet me nenin 70.2 të Shtojcës së Ligjit me nr 04/L-033. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit me Nr. 04/L-034, është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit. Me tutje ka shtuar se Autoriteti i Likuidimit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga paditësi në procedurë të likuidimit drejtë ka vepruar ngase nuk ekziston në mbështetje të lëndës asnjë aktgjykim i plotfuqishëm cili i pranon pretendimet e parashtruesit të paditësit. Po ashtu ka theksuar se pretendimet e parashtruesit janë të pa bazuara edhe për faktin se edhe parashtruesi nuk ka prezantuar prova për ta mbështetur kërkesën e parashtruar. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

### Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Në rastin konkret gjykata ka konstatuar se parashtruesi i kërkesës pranë palës kundërshtare ka parashtruar kërkesë përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara si ish punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore Eurometal (në likuidim) dhe atë për periudhën nga muaji maj-tetor 1990, në shumën prej 2,200.00€. Pala kundërshtare e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i saj në atë procedurë dhe ka konstatuar se kërkesa është e parashtruar brenda afatit për dorëzimin e kërkesave dhe me vendimin GJI057-0206, kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i saj në atë procedurë e ka refuzuar si të pa bazuar duke u bazuar në nenin 36.1 të Shtojcës së Ligjit me nr.04/L-034, mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Paditësi pranë kësaj gjykate ka pretenduar në paga të pa paguara nga ndërmarrja dhe për këtë detyrim të pretenduar ka parashtruar si provë propozimin e parashtruar pranë Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar. Në anën tjetër pala kundërshtare e ka kontestuar kërkesëpadinë me pretendimin se pala paditëse nuk ka prezantuar prova të mjaftueshme që e mbështetin kërkesëpadinë. Nuk ka prezantuar vendimin e gjykatës në lidhje me propozimin e ushtruar.

Kompensimi i pagave është e rregulluar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 që parashihet “kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuara në tri paga mujore bruto për person”. Nga këto dispozita është e përcaktuar se punëtori gëzon të drejtën në pagat e pa paguara e të kufizuara në tri paga “Nëse punëtori ka qenë duke punuar në vendin e punës, kur Bordi i AKP-së, ka marr vendimin për fillimin e procedurës së likuidimit dhe nëse vërtetohet se punëtorit nuk ju janë paguar pagat”. Në rastin konkret parashtruesi i anekses ka pretenduar në paga të cilat i përkasin periudhës kohore të vitit 1990, dhe se ka pretenduar se gjatë kësaj periudhe padrejtësisht është larguar nga puna dhe se për këtë arsye ka parashtruar propozim në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar. Nga provat e shqyrtuara gjykata nuk ka gjetur se parashtruesi i padisë nuk ka prezantuar prova të mjaftueshme që e mbështetë kërkesën. Nuk ka prezantuar vendimin e gjykatës në lidhje me propozimin e parashtruar. Rrjedhimisht duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe nenit 322.1 të LPK-së, gjykata ka ardhur në përfundimin se pala paditëse me provat e prezantuara nuk ka mundur që t’i argumentoj pretendimet e dhëna me padi, rrjedhimisht edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Shpenzimet Gjyqësore:** Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës secila palë do ti heqë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit kohor prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari,  
Asllan Krasniqi